



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER SOKOL SH. MALAJ**  
**ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI**  
**TEL: 684055554**

# **KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME**

**(KUOTA KAPITALI)**

**Nr. repertori: 541**

**Nr. koleksioni: 217**

**Tirane më 17/03/2021**

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050710022640449



A2021050710022640449

**KONTRATË SHIT-BLERJE  
E KUOTAVE TË KAPITALIT**  
*Në bazë të Ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008  
për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “*

Sot më datë 17 Mars 2021 (dymijë e njëzet e një) ditën e mërkurë para meje Noterit **Sokol Sh. MALAJ**,  
Noter në Degën Vendore të Noterisë Tiranë me seli në Rr.”L.Gurakuqi” u paraqitën personalisht:—

**PALA SHITËSE:**

**Z.ADRIAN KËRÇIKU** i biri i Faik, dhe Vera, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë,  
me adresë Rr.”Thanas Ziko” P29 Sh1 Ap16; Nd. Njësia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017;  
Tiranë, lindur më 06/09/1970, gjendja civile “i martuar”, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim  
ID nr. 033339621 dhe nr. personal H00906084O madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.—

Dhe bashkëshortja e cila jep pëlqimin për këtë veprim juridik

**Znj.XHILDA DHONATO**, e bija e Oresti, dhe Pranvera, shtetase Shqiptare, lindur në Kavajë, Durrës  
dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr.”Thanas Ziko”; Nd. 29; H. 1; Ap. 16; Njësia Administrative Nr. 8; Tiranë;  
0000; Tiranë, lindur më 26/07/1975, gjendja civile “e martuar”, madhore, për identitetin e të ciles u garantova  
me Leternjoftim ID nr. 032217354 dhe nr. personal H55726114T me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**PALA BLERËSE:**

**Z.RUDI STËRMASI** i biri i Ali dhe Hatixhe, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë,  
me adresë Rr.”Luigj Gurakuqi”; Nd. 19/1; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003;  
Tiranë, lindur më 30/05/1977, gjendja civile “i martuar”, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim  
ID nr. 034867701 dhe nr. personal H70530071G madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.—

Të lartpërmendurit janë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët pasi u sqaruan për  
pasojat juridike që sjell ky akt noterial, deklaruan se lidhin Kontratën e shitblerjes të kuotave të kapitalit me  
kushtet si vijon:—

Pala shitëse, me vullnetin e saj të lirë e të plotë deklaroi se është bashkëpronar i ligjshëm në pjesët e  
kapitalit që përcaktohet në ekstraktin e QKB, respektivisht:

- **Z.RUDI STËRMASI** ka në pronësi kuotën prej 50% të kapitalit.—
- **Z.ADRIAN KËRÇIKU** ka në pronësi kuotën prej 50% të kapitalit.—

Nisur nga interesat e tyre dhe në bazë të Vendimit të asamblesë së ortakëve me Nr 1 datë 15.03.2021,  
Ortaku **Z.ADRIAN KËRÇIKU** ka rënë dakord që kuotën e tij prej 50,00% e kapitalit që ai ka në këtë shoqëri  
t’ia shesë blerësit/Ortakut **Z. RUDI STËRMASI**.—

Çmimi i shitjes, për kuotën prej 50% të kapitalit, në bazë të marrëveshjes së arritur nga palët jashtë kësaj  
Zyre, është caktuar në vlerën prej **50.000 ALL (pesëdhjetë mijë lekë)**.—



A2021050710022640449

Pala shitëse deklaron se kjo shumë i është likuiduar plotësisht jashtë kësaj zyre nga pala Blerëse, me para në dorë (CASH).—

Edhe Blerësi/Ortaku **Z. RUDI STËRMASI** deklaron se pranon të blejë kuotën prej 50,00% kapitalit në shoqërinë e mësipërme në çmimin që ata kanë caktuar në marrëveshje të përbashkët, shumë kjo që i është likuiduar plotësisht Shitësit/Ortakut jashtë kësaj zyre me para në dorë (CASH).

Me likuidimin e plotë të vlerës së shitjes, pra të çmimit prej **50.000 ALL (pesëdhjetë mijë lekë)**, shitësi humbet të drejtën e pronësisë në kuotën prej 50,00% të kapitalit, ndërsa Blerësi/Ortaku **Z. RUDI STËRMASI** fiton pronësinë në kuotën prej 50,00% të kapitalit, në Shoqërinë “**A&R PAZARI FRIENDS**” shpk.—

Veç sa më sipër, Blerësi/Ortaku deklaron se është dakord që të blejë këtë kuotë në shoqërinë që ai vetë administron me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ajo ka. Blerësi/Ortaku deklaron se është në dijeni të plotë të gjendjes aktuale financiare të kësaj shoqërie (pra shoqërisë së tij), se ka kontrolluar librat e kontabilitetit dhe se nuk ka asnjë pretendim apo mosmarrëveshje.—

Pra, me hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Noterial, shitësi **Z. ADRIAN KËRÇIKU** humbet bashkëpronësinë për kuotën e tij të kapitalit në këtë shoqëri dhe blerësi/ortaku **Z. RUDI STËRMASI** bëhet ortak i vetëm i shoqërisë në kuotën prej **100,00% të kapitalit**.—

Pala shitëse nga data e nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotave zhvishet nga të gjitha të drejtat, asetet, Licencat përkatëse, dhe detyrimet që ka shoqëria “**A&R PAZARI FRIENDS**” shpk ndaj paleve te treta dhe insitucioneve shtetërore, detyrime të cilat i ngarkohen palës blerëse.

Blerësi/Ortaku i vetëm i shoqërisë është i detyruar të paraqesë pranë **Q.K.B.** Vendimin e Ortakëve dhe aktin noterial të shitjes së kuotave në favor të tij.—

Për të vërtetuar sa më sipër, u hartua prej meje Noterit kjo kontrate Shit-Blerje e kuotave të kapitalit e cila pasi u lexua nga palët dhe u gjet sipas vullnetit të palëve, u nënshkrua në praninë time sipas ligjit dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

**PALA SHITËSE:**

**Z. ADRIAN KËRÇIKU**

*Adrian Kerciku*

dhe bashkëshortja e cila jep pëlqimin për këtë veprim juridik

**Znj. XHILDA DHONATO**

*Xhilda Dhonato*

**PALA BLERËSE:**

**Z. RUDI STËRMASI**

*Rudi Stërmasi*

*[Signature]*

**NOTERI  
SOKOL SH. MALAJ**

**TAKSA E PULLES  
Ë PAGUA**



**NOTER. SOKOL SH. MALAJ** Fq. 2  
RR "LUIGJ GURAKUQI" P 2 TIRANË, ALBANIA  
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4  
e-mail: kolimalaj@hotmail.de